

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Përkthime dhe Publikime për nevojat e Ukt sh.a ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Publikime
22120000-7

Shërbime të përkthimit 79530000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 3.373.433 (tre milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind e tridhjetë e tre) leke pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Bazuar në pikën 3 neni 45 të VKM 285 datë 19.05.2021 ku autoriteti mund të mbështetet në oferten ekonomikisht më të favorshme të bazuar në çmim.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës sipas 3 konkretisht në vlerën 67,468.66(gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e egjashtë) lekë.*

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Neni 43, pika 4, të VKM nr. 285 "Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse

kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006) “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet të kryera gjatë tri viteve të fundit (përllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40/4, si dhe neni 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", citohet: "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.1 . Përkthyesi zyrtar përzgjidhet, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

1. Përkthyesi zyrtar përzgjidhet, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:
 - a) arsimimi në fushën për të cilën kërkohet përkthimi;
 - b) vendbanimi i përkthyesit zyrtar ose vendi i ushtrimit të veprimtarisë së përkthimit zyrtar të jetë në apo pranë juridiksionit të organit kontraktues;
 - c) vlerësimet e shërbimit të ofrimit të përkthimit zyrtar, të bëra nga palët kontraktuese të mëparshme;
 - ç) eksperiencat e mëparshme profesionale në fushën për të cilën kërkohet përkthimi;
 - d) studimet e thelluara ose trajnimet e vazhdueshme në fushën për të cilën kërkohet përkthimi;
 - dh) eksperiencat profesionale të mëparshme të përkthyesit zyrtar me palën kontraktuese përzgjedhëse.

2.3.2. Në rastet e përkthimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian në gjuhën shqipe dhe të legjislacionit shqiptar në njërën nga gjuhët e Bashkimit Evropian, përveç kriterëve të mësipërme, përkthyesi zyrtar përzgjidhet, duke u bazuar edhe në kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë kryer edhe më parë përkthime të *acquis* të Bashkimit Evropian;
- b) të ketë tituj dhe grada shkencore në gjuhën për të cilën konkurrojnë ose në fusha specifike të *acquis* të Bashkimit Evropian;
- c) të ketë gjuhë amtare gjuhën e burimit nga e cila kërkojnë të përkthejnë

2.4 Përkthyesi duhet të jetë i publikuar në listen e faqes zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë

Kriteret e përcaktuara në pikat 2.3.1, 2.3.2 dhe 2.4 janë vendosur në mbështetje të **VKM nr. 407, datë 05.07.2023, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të rregullave për përzgjedhjen, kontraktimin dhe shpërblimin e përkthyesve zyrtarë, si dhe të mënyrës së kontrollit të shërbimit të kryer nga përkthyesit zyrtarë"**, e cila rregullon mënyrën e përzgjedhjes së përkthyesve zyrtarë dhe kriteret profesionale që duhet të plotësojnë ata.

Në zbatim të këtij akti nënligjor, Autoriteti Kontraktor ka pasqyruar në Dokumentet Standarde të Tenderit kriteret e parashikuara nga VKM-ja, pa vendosur kërkesa shtesë apo kufizuese, me qëllim garantimin që shërbimi i përkthimit zyrtar të realizohet nga përkthyes të autorizuar, të kualifikuar dhe me përvojën e nevojshme profesionale.

Duke qenë se objekti i kontratës përfshin përkthime zyrtare për nevojat e Autoritetit Kontraktor, përfshirë dokumente administrative, teknike, dokumentacion të procedurave të prokurimit publik, si dhe, sipas rastit, përkthimin e direktivave, rregulloreve dhe akteve të tjera të legjislacionit të Bashkimit Evropian, kërkohet që përkthyesi të plotësojë kriteret profesionale të përcaktuara në VKM nr. 407/2023, në mënyrë që të garantohet saktësia terminologjike, cilësia profesionale dhe vlefshmëria juridike e përkthimeve.

Gjithashtu, kërkesa që përkthyesi të jetë i publikuar në listën zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë garanton se ai është i regjistruar dhe i autorizuar për ushtrimin e veprimtarisë së përkthimit zyrtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Publikimi në këtë listë përbën provën objektive të plotësimit të kushteve ligjore dhe profesionale për ofrimin e këtij shërbimi.

Për rrjedhojë, kriteret e mësipërme janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin dhe natyrën e kontratës, janë proporcionale me shërbimin që prokurohet dhe burojnë drejtpërdrejt nga VKM nr. 407, datë 05.07.2023, duke garantuar përzgjedhjen e përkthyesve zyrtarë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe sigurimin e një shërbimi cilësor, të besueshëm dhe me vlefshmëri juridike.

Njësia e Prokurimit

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës, me qëllim garantimin e ofrit të një shërbimi cilësor, të vazhdueshëm dhe në përputhje me kërkesat ligjore të Autoritetit Kontraktor.

Objekti i kontratës konsiston në ofrimin e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe publikimit të dokumenteve të nevojshme për veprimtarinë e UKT sh.a., të cilat lidhen me procedurat e prokurimit publik, marrëdhëniet institucionale, dokumentacionin teknik, administrativ dhe çdo dokument tjetër për të cilin kërkohet përkthim zyrtar ose publikim.

Sasia e pritshme prej **rreth 1,569 faqesh për përkthim dhe 20 publikimeve** është përcaktuar mbi bazën e nevojave të identifikuara nga Autoriteti Kontraktor, duke marrë në konsideratë volumin e dokumentacionit të përkthyer dhe të publikuar gjatë periudhave të mëparshme, si dhe nevojat e parashikuara për periudhën e zbatimit të kontratës.

Për shkak se nevojat për përkthime dhe publikime krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit të Autoritetit Kontraktor dhe nuk mund të përcaktohen me saktësi paraprakisht në aspektin e kohës dhe volumit, kontrata është parashikuar të realizohet në formën e marrëveshjes kuadër me afat **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e nënshkrimit të saj. Ky afat siguron mbulimin e nevojave të Autoritetit Kontraktor gjatë gjithë periudhës së zbatimit, duke garantuar ofrimin e shërbimit sa herë që lind nevoja, pa ndërprerje dhe në përputhje me kërkesat operative të institucionit.

Specifikimet teknike nuk përmbajnë kërkesa që favorizojnë apo diskriminojnë operatorë të caktuar ekonomikë, por janë hartuar në funksion të sigurimit të cilësisë së shërbimit, vlefshmërisë ligjore të përkthimeve zyrtare dhe realizimit të publikimeve sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke respektuar parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë